[Shqiptarja.com]

Kërko

POP 5 Lajmet më të lexuara të 5 minutave të fundit

1  Aksidenti i rëndë në Elbasan, ndërron jetë një prej pasagjerëve të makinës 'Volkswagen'

2  E dielë 'e zezë', 6 aksidente, humbin jetën 4 persona! Makina përplaset me minibusin në Elbasan, plagosen 7 qytetarë, ndërron jetë një tjetër

3  Biznesmeni Petrit Ago fiton betejën me COVID, i bën 'dhuratë speciale' mjekut Tritan Kalo për Vitin e Ri: Falë jush kam filluar një jetë të dytë

4 

Aktualitet

# Elbasan/ Dhunonte bashkëshorten dhe e kërcëntonte me armë pa leje, arrestohet 35-vjeçari

*Gjatë kontrollit në banesë, policia gjeti një armë zjarri tip pushkë dhe 44 fishekë që i mbante pa lejen përkatëse.*



*Foto ilustruese*

Redaksia
16 Tetor 2019, 12:31 | Përditesimi i fundit: 16 Tetor 2019, 14:34

RAPORTO! Chat live me Shqiptarja.com

Share 10 Tweet




**ELBASAN-** Një 35-vjeçar është arrestuar pasi dhunonte bashkëshorten dhe mbante një armë pa leje në banesë me të cilën e kërcënonte.

Astrit Sollaku banon në Belsh në lagjen e Hysajve bashkë me bashkëshorten, të cilën e dhunonte për motive të dobëta.





LEXO EDHE:
**FOTOLAJM/ Range Rover-i përfundon mbi trafikndarësen pranë tunelit Tiranë-Elbasan**


Ai e kshte dhunuar dhe herë të tjera bashkëshorten, por ajo nuk e denonconte nga frika mos e qëllonte me armë.

Ata kanë një femijë bashkë.

Gjatë kontrollit në banesë, policia gjeti një armë zjarri tip pushkë dhe 44 fishekë që i mbante pa lejen përkatëse.

Sipas policisë materialet i kaluan Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan, për veprimet e mëtejshme.

**TAG:** arrestim elbasan dhune ne familje bashkeshortja pushke

© Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016




RAPORTO! Chat live me Shqiptarja.com